



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr. 179/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesues, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), paraqitur kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike (IRDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 26.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet e palejuar ankesa e parashtruara nga subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), A.nr.179/2025 e datës 24.01.2025, paraqitur kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike (IRDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datën 24.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Partia Liberale Egjiptiane, ku pretendohet se kryetari i partisë Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK, në të cilën theksohet se më datën 23.01.2025, në profilin e tij në facebook ka publikuar një video incizim përkatësisht Spot Politik, ku shihen fëmijët e moshës së mitur nën 16 vjeçare, në këtë mënyrë Elbert Krasniqi, në cilësi të kryetarit të IRDK-së, në këtë incizim ka keqpërdorur fëmijët e mitur kinse duke bërë prezantimin e kinse të arriturave gjatë mandatit të tij si ministër i MAPL-së. Më tej parashtruesi i ankesës ka theksuar se me këto veprime i njëjti, ka keqpërdorur fëmijët e mitur, sidomos ata të moshës nën 16 vjeçare, duke e ditur se fëmijët janë kategori e ndjeshme e shoqërisë dhe ekspozimi i tyre është i kundërligjshëm dhe bie ndesh me nenin 45, par.3 të Ligjit NR. 06/L-084 Për Mbrojtjen e Fëmijëve, që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve në masmedia, ashtu që me këtë nen është e përcaktuar se "Mjetet e komunikimit masiv, përfshirë mediat e shkruara dhe elektronike, botimet, televizionin, radion, reklamat, kinemanë, internetin dhe mediat online, portalet, janë të obliguara që të kontribuojnë në mënyrë aktive për të afirmuar mbrojtjen e fëmijës me realizimin e

veprimtarive vetëdijesuese dhe duke këshilluar publikun mbi ndikimet e mundshme negative që ekspozimi ndaj mediave mund të ketë mbi fëmijën".

Në përgjigjen në ankesë të Elbert Krasniqi, Kryetar i Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës - IRDK, thekson se për të njëjtën çështje me të njëjtën përmbajtje shkresore subjekti politik PLE ka dorëzuar paraprakisht pranë PZAP-it ankesën Anr 134/2025 të cilën e ka refuzuar të pabazuar ndërsa ankesën Anr 143/2025 e ka pranuar si të bazuar dhe subjektin politik IRDK e ka ndëshkuar me 1500 euro, dhe se kjo çështje është çështje e gjykuar.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga subjekti politik PLE, ka njëjtësi objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën Anr.143/2025 të paraqitur me datën 23.01.2025 nga po i njëjti subjekt politik PLE, kundër subjektit politik IRDK, e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 143/2025 të datës 24.01.2025 subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike (IRDK) i është shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej 1,500.00(njëmijë e pesëqind) euro.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.143/2025 të datës 24.01.2025, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të çështjeve të theksuara në ankesë.

Prandaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura lart, në pajtim me nenin 115.1 dhe 118.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 179/2025 më datën 26.01.2025

Kryesuese e Panelit



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.